

**Ligjërishit (t'pa) Diplomuar?
(Punim Diskutues)**

Përgatitur nga: Blend Zyrapi dhe Valdrin Ukshini.

Editor: Ariana Qosaj-Mustafa

Copyright © 2019, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rrikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 542 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III. No.1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 542 778

Shkurtesat:

MASHT- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

AKA- Agjencia Kosovare e Akreditimit

IAL- Institucionet e Arsimit të Lartë

BPrAI- Bartësit Privat të Arsimit të Lartë

SMIAL- Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë

UA- Udhëzim Administrativ

Hyrje:

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) dhe Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) janë rregullatorët kyç të Arsimit të Lartë në Kosovë. AKA është përgjegjëse për akreditimin dhe ri-akreditimin e bartësve të arsimit të lartë në Kosovë, ndërsa MASHT është përgjegjëse për licencimin e bartësve të arsimit të lartë në Kosovë.¹

Ky raport i shkurtër shqyrton “problemin e pa mundësisë për t’i verifikuar diplomat e studentëve që kanë përfunduar studimet tek Bartësit Privat Të Arsimit Të Lartë (Kolegjet). Në bazë të udhëzimeve administrative deri në vitin 2016 Bartësit Privat Të Arsimit Të Lartë (BPrAL) kanë qenë të obliguar të dorëzojnë në MASHT “Librat Amëz” me anë të cilave verifikohet numri i studentëve që kanë pranuar për vitin akademik. Ndërsa pas viti 2016 MASHT ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 12/2016 për themelimin dhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave të arsimit të lartë - sistemi SMIAL, BPrAL-t janë të obliguar të dhënat e studentëve që kanë pranuar për vitin akademik ti paraqesin në mënyrë elektronike në sistemin SMIAL².

¹ Ligji Nr. 04/L-037, Ligji për arsimin e lartë në Kosovë, neni 11, paragrafi 3, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>

² Udhëzimi administrative 12/2016, për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf> (qasur 23 nëntor 2017)

Historia e Udhëzimeve Administrative të nxjerra nga MASHT

Në bazë të Udhëzimit Administrativ 13/2018 për Sistemit dhe Menaxhimin e Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL), MASHT-i është përgjegjës i sistemit SMIAL si dhe përgjegjës në menaxhimin dhe grumbullimin e të dhënave nga bartësit e arsimit të lartë në Kosovë.³

Para hyrjes në fuqi të UA 13/2018 për menaxhimin dhe grumbullimin e të dhënave të arsimit të lartë, MASHT-i është udhëhequr në punën e vet përmes disa Udhëzimeve Administrative nga vitet e kaluara. Në muajin maj të vitit 2014 MASHT- kishte nxjerrë UA 20/2014 për librat amëz të studentëve të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.⁴ Ky UA parashikonte që çdo institucion i arsimit të lartë ishte i obliguar që të plotësonte dhe të ruante librat amëz të studentëve,⁵ të cilat duhet të plotësoheshin dhe të dërgoheshin në MASHT në formë elektronike në fillim të vitit akademik. Me UA 20/2014, ishte përcaktuar edhe afati kohor për studimet themelore më së largu me 15 tetor, ndërsa për studimet master dhe doktoratë më së largu deri me 15 nëntor.⁶ Dorëzimi në MASHT i kopjes fizike të origjinalit të librit amëz kishte përcaktuar afatin kohorë 20 tetor për studime themelore dhe 20 nëntor për studime master dhe doktoratë.⁷ Ndërsa në po të njëjtin vit dhe atë pas pesë muajve në tetor 2014, MASHT-i shfuqizon UA 12/2014 dhe nxjerr një udhëzim administrativ të ri 33/2014.⁸ Mirëpo Udhëzimi Administrativ 33/2014 është i njëjti me udhëzimin e shfuqizuar administrativ 12/2014 dhe si i tillë nuk ka pësuar ndonjë plotësim apo ndryshim.⁹ Në këto dy udhëzime administrative, MASHT-i nuk ka paraparë asnjë masë ligjore për mos-zbatimin e tyre nga institucionet e arsimit të lartë.

³ Udhëzimi Administrativ 12/2016, për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, Neni 5 paragrafi 1.1, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf>, UA ka hyre ne fuqi me 06 qershor 2016

⁴ Udhëzimi administrativ 20/2014, libri amëz të studentëve të institucioneve të arsimit të lartë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10188> (qasur 23 nëntor 2017)

⁵ Po aty, neni 2 paragrafi 1 dhe 2,

⁶ Po aty, neni 3 paragrafi 1 dhe 2,

⁷ Po aty, neni 3 paragrafi 3,

⁸ Udhëzimi administrative 33/2014, libri amëz të studentëve të institucioneve të arsimit të lartë, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-nr-33-2014.pdf> (qasur 23 nëntor 2017)

⁹ Shiko udhëzimin administrativ 20/2014, libri amëz të studentëve të institucioneve të arsimit të lartë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10188>, si dhe UA 33/2014, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-nr-33-2014.pdf>

Në anën tjetër, në vitin 2016 MASHT ka nxjerrur Udhëzimin Administrativ 12/2016 për themelimin dhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave të arsimit të lartë - sistemi SMIAL,¹⁰ i cili rregullon grumbullimin dhe monitorimin e të dhënave për IAL-të në mënyrë të digjitalizuar.¹¹ Poashtu, ky udhëzim administrativ ka përcaktuar edhe afatet për raportimin e të dhënave nga IAL-të.¹² Për ciklin e studimeve baçelor, IAL obligohen që të dhënat e studentëve ti raportojnë deri me 30 shtator, për master 31 tetor, dhe për doktoratës 31 tetor dhe 15 mars.¹³ Në këtë UA është paraparë edhe masa ligjore e tërheqjes së licencës, në rast se IAL-të nuk raportojnë të dhënat në afatet e përcaktuara.¹⁴

Mirëpo, vetëm një vit pas nxjerrjes së UA 12/2016, MASHT-i bënë plotësimin dhe ndryshimin e tij dhe ate në pjesët ku përcaktohen afatet kohore të raportimit të të dhënave, si dhe tek pjesa ku janë paraparë masat ligjore. Për ciklin Baçelor, afati kohor për dorëzimin e të dhënave është shtyer deri më 15 nëntor,¹⁵ ndërsa për nivelin master është shtyer më 20 nëntor.¹⁶ Ndryshime kishte edhe tek masa ligjore, me ç'rast u hoq masa tërheqjes së licencës për ato institucione të cilët nuk raportojnë të dhënat sipas afateve të caktuara,¹⁷ dhe ajo u zëvendësua me mos lejimin e futjes dhe përditësimin e të dhënave në sistemin SMIAL, në rast se raportojnë jashtë afateve kohore.¹⁸

Kjo heqje e masës së tërheqjes së licencave të IAL-të në rast të shkeljes së normave ligjore për kohën e raportimit dhe numrin e studentëve të regjistruar, hapë rrugë parregullsive madhore në administrimin e arsimit të lartë në Kosovë dhe ate sidomos në sektorin privat, pasi praktikisht zbatimi i normave ligjore nga IAL-të mbetet në vullnetin e mirë të tyre.

¹⁰ Udhëzimi administrative 12/2016, për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf> (qasur 23 nëntor 2017)

¹¹ Po aty, neni 3 paragrafi 1.2

¹² Po aty, neni 6 paragrafi 1.2

¹³ Po aty, neni 7 paragrafi 1,2,3

¹⁴ Po aty, neni 12

¹⁵ Udhëzimi administrative 11/2017, Për plotësim dhe ndryshim të UA 12/2016 për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, Neni 2 paragrafi 1 dhe 2, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf>, UA ka hyre ne fuqi me 25 gusht 2017

¹⁶ Po aty,

¹⁷ Udhëzimi administrative 12/2016, neni 12, për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf> (qasur 23 nëntor 2016)

¹⁸ Udhëzimi administrative 11/2017, Për plotësim dhe ndryshim të UA 12/2016 për menaxhimin edhe funksionalizimin e sistemit për menaxhimin e informatave në arsimin e lart, Neni 2 paragrafi 4, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/merged-2.pdf>, UA ka hyre ne fuqi me 25 gusht 2017

Po ashtu, në shtator të 2018 MASHT-i ka nxjerr edhe një udhëzim administrativ “Për Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë” (SMIAL), përmes të cilit parashihen menaxhimi i informatave në Arsimin e Lartë përmes platformës në regjistrimit, grumbullimit të dhënave statistikore¹⁹. Në të cilin, po ashtu parashihen afatet kohore se kur Institucione e Arsimit të Lartë duhet ti dorëzojnë në MASHT të dhënat e studenteve të pranuar në vitin akademik në tre nivele Bachelor, Master dhe Doktoratës.²⁰ Neni 7 i këtij UA parasheh që IAL-t duhet t’i vendosin të dhënat në sistemin SMIAL, deri me datën 15 tetor për nivelin Bachelor, deri me 10 nëntor për nivelin Master, ndërsa për programin e Doktoratës parashihen dy afate, nga 25-30 nëntor si dhe afati i dytë 10-15 mars.²¹ Po ashtu në këtë udhëzim administrativ parashihet që pas futjes të dhënave në sistemin SMIAL, IAL-të janë të obliguar t’i dorëzojnë kopjet fizike në MASHT²². Ndërsa në nenin 14 të këtij UA parashihen edhe masat ndëshkuese për IAL të cilët nuk i përmbahen afateve kohore për dorëzimin e të dhënave²³.

KIPRED, në kontributin e ofruar gjatë javës kundër korrupsionit të vitit 2017 me punimin “Ministria Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe Agjencia e Akreditimit: Amnistues të Shkelësve të Ligjit”²⁴ e ka ngritur çështjen e mos zbatimit të udhëzimeve administrative nga Bartësit Privat të Arsimit të Lartë në Kosovë. Për mos dorëzimin e të dhënave nga BPrAL në atë kohë e patë konfirmuar edhe ish ushtruesja e detyrës së drejtorit të AKA-së znj. Furtuna Mehmeti, e cila patë theksuar se “kemi informatat jo zyrtare se institucionet i kanë vonuar librat amëz në MASHT, dhe se kjo krijon mundësi për BPrAL të regjistrojnë studentë edhe pas afatit

¹⁹ Shiko udhëzimin administrativ 13/2018, Për Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë, https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/10/ilovepdf-merged_1.pdf

²⁰ Po aty,

²¹ Po aty, Neni 7.

²² Po aty, Neni 8.

²³ Po aty, Neni 14.

²⁴ KIPRED - Ministria Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe Agjencia e Akreditimit: Amnistues të Shkelësve të Ligjit, [http://www.kipred.org/repository/docs/Punimi_Per_Javen_Anti_Korrupsion,KIPRED_\(2\)_288536.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Punimi_Per_Javen_Anti_Korrupsion,KIPRED_(2)_288536.pdf)

të përcaktuar.”²⁵ Të njëjtën gjë e patën konfirmuar edhe zyrtarja e MASHT-it, znj. Drita Kadriu e cila patë theksuar se deri më tani jo të gjitha kolegjet i kanë dorëzuar të dhënat në SMIAL.²⁶

Problemi me verifikimin e diplomave

Problemin e mos dorëzimit të librave amëz nga BPrAL, e kishte raportuar Udhëheqësja e divizionit për Njohje dhe Barasvlerë të Diplomave të divizionit NARIC pranë MASHT-it, e cila në vitin 2018 i kishte shkruar letër Ministrit të Arsimit z. Shyqyri Bytyqi. Ajo përmes letrës i ka shpjeguar të gjitha shkeljet ligjore që BPrAL kanë bërë nga mos dorëzimi i librave amëz²⁷, duke e paralajmëruar për pamundësinë verifikimit të diplomave të studentëve që kanë përfunduar studimet pranë disa BPrAL. Kjo e gjitha për shkak të mos dorëzimit, apo dorëzimit jashtë afateve kohore të parapara me UA.²⁸

Për ironi, ministri i Arsimit z. Bytyqi në vend se të trajtoj shkeljet ligjore nga kolegjet private, kishte vendosur të ja ndërroj pozitën zyrtares në MASHT.²⁹ Edhe pse ligji “Për Mbrojtjen e Informatorëve” i cili ka qenë në fuqi gjatë periudhës së raportimit të këtyre shkeljeve, i mbron informatorët nga masa të dënimit, masa disiplinore, pushimit apo suspendimit nga puna si dhe masave diskriminuese³⁰. Ky ligj është shfuqizuar³¹ me miratimin e ligjit “Për Mbrojtjen E Sinjalizuesve” i cili ka hyrë në fuqi në dhjetor 2018, i cili mbron sinjalizuesit nga “përgjegjësisë

²⁵ Sqarim Kjo Intervistë është Mbajtur Në Vitin 2017 dhe është në punimin e prezantuar nga KIPRED [http://www.kipred.org/repository/docs/Punimi_Per_Javen_Anti_Korrupsion,KIPRED_\(2\)_288536.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Punimi_Per_Javen_Anti_Korrupsion,KIPRED_(2)_288536.pdf), Intervistë, mbajtur më 14 nëntor 2017, me ish ushtruesen e detyrës së drejtorit në AKA znj. Fortuna Mehmet si dhe Bekim Samadragja i caktuar nga MASHTI në muajin shtator ushtrues detyre i drejtorit në AKA.

²⁶ Sqarim Kjo Intervistë është Mbajtur Në Vitin 2017 dhe është në punimin e prezantuar nga KIPRED [http://www.kipred.org/repository/docs/Punimi_Per_Javen_Anti_Korrupsion,KIPRED_\(2\)_288536.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Punimi_Per_Javen_Anti_Korrupsion,KIPRED_(2)_288536.pdf), Intervista me drejtoren e departamentit të arsimit të lart në MASHT znj. Drita Kadriu, e mbajtur me datë 17 nëntor 2017, në Ministrinë e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.

²⁷ Veriu.info, Shih të bashkangjitur në linkun mëposhtë letrën e plotë që zyrtarja e MASHT-it Znj.Kumrije Gagica ia kishte dërguar Ministrit Arsimit Z. Shyqyri Bytyqi, për shkeljet e kolegjeve private, <http://www.veriu.info/kjo-eshte-letra-e-plote-ge-kumrije-gagica-ia-kishte-derguar-ministrin-te-arsimit-per-shkeljet-e-kolegjeve-private/> (Qasur nëntor 2019)

²⁸ Po aty,

²⁹ Kallxo.com, MASHT ia ndërron pozitën zyrtares që refuzoi validimin e parregullt të diplomave të kolegjeve private. https://kallxo.com/gjate/hulumtim/masht-ia-nderron-poziten-zyrtares-ge-refuzoi-validimin-e-parregullt-te-diplomave/?fbclid=IwAR1tF_xfGbUmKhWQfjDrXUxNKDVKYIYoB_fay6Dgyb0CE6KI6-JJArId_IA (Qasur nëntor 2019)

³⁰ Ligji Nr. 04/L-043 Për Mbrojtjen e Informatorëve, neni 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2763>

³¹ Ligj Për Mbrojtjen E Sinjalizuesve, neni 31, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/C963FC32-6A32-4126-B36B-A1DEFBBA1495.pdf>

penale ose civile apo procedurave disiplinore”³². Për më tepër ky ligj parasheh tri lloje të sinjalizimit, ku në rast se informacioni raportohet tek punëdhënësi kjo konsiderohet sinjalizim i brendshëm, në rast se informacioni raportohet tek autoriteti publik atëherë kjo konsiderohet sinjalizim i jashtëm, ndërsa në rast se informacioni shpaloset apo raportohet në media, tek organizatat joqeveritare apo përmes internetit, kemi të bëjmë me sinjalizim publik.³³

Mos arritja e verifikimit të diplomave është raportuar nga mediat në vitin 2018, ku studentët gjeneratës të vitit 2014/2015 të Kolegjit UBT-ës nuk kanë arritur ta bëjnë vërtetimin e diplomave për shkak të mungesës të “librave amëz” në MASHT³⁴. Edhe pse kolegji UBT kishte deklaruar se posedon njëren kopje të librave amëz, ndërsa kopjen tjetër e kanë dorëzuar pranë MASHT-it.³⁵

Po ashtu, problemin e vërtetimit të diplomave nuk e kanë vetëm studentët e Kolegjit UBT por edhe disa kolegje të tjera. Në bazë të raportit mbi gjendjen faktike të librave amëz në MASHT, të cilën e ka siguruar KIPRED-i³⁶, janë 10 kolegje, të cilave u mungojnë librat amëz për një ose disa gjenerata³⁷, si rrjedhojë studentët e këtyre kolegjeve nuk mundën ti verifikojnë diplomat e tyre. Sipas këtij raporti, madje ka kolegje që për tre gjenerata të viteve 2014,2015 dhe 2016 nuk i ka dorëzuar librat amëz dhe se MASHT-i nuk mundet ti vërtetojnë diplomat e studentëve të atij kolegji dhe ligjërisht studentët konsiderohen të pa diplomuar.³⁸ Në raport nuk jepet numri i saktë i studentëve që nuk mund t’i vërtetojnë diplomat, por në bazë të një parallogaritje nga ana e jonë mund të jenë me mijëra studentë që do ta kenë këtë problem.

Në anën tjetër, ka disa kolegje që nuk janë të përfshira në raport që posedojnë “letrën përcjellëse të protokolluar nga MASHT-i” përmes të cilës vërtetohet se kolegjet kanë dorëzuar librat amëz në MASHT. Mirëpo, zyrtarët e MASHT-it deklarojnë se pavarësisht se kolegjet posedojnë

³² Po aty, neni 9, paragrafi 1.

³³ Po aty, neni 13.

³⁴ Koha.net: Studentët e një gjenerate në UBT në vështirësi për vërtetimin e diplomave, faji hidhet te MASHT-i, <https://www.koha.net/arberi/177648/studentet-e-nje-gjenerate-ne-ubt-ne-veshtiresi-per-vertetimin-e-diplomave-faji-hidhet-te-masht-i/>

³⁵ Po aty,

³⁶ Raport mbi gjendjen faktike të librave amëz i dërguar nga zyrtarët e MASHT-it.

³⁷ Po aty,

³⁸ Po aty,

“letrën përcjellëse të protokolluar nga MASHT-i”, këto libra amëz nuk gjenden në MASHT dhe se nuk mund të bëhet vërtetimi i diplomave të studentëve.³⁹

Në rast se vërtetohet se BPrAL kanë dorëzuar librat amëz pranë MASHT-t dhe se librat amëz nuk gjenden në MASHT siç kanë deklaruar zyrtarët atëherë ngritët dyshimi se këto dokumentacione zyrtare janë zhdukur ose asgjësuar, dhe kjo në bazë të kodit penal përbën veprë penale.⁴⁰

Po ashtu, nëse vërtetohet se BPrAL nuk kanë dorëzuar librat amëz pranë MASHT-it siç deklarojnë zyrtarët e Ministrisë së Arsimit dhe se diplomat e studentëve nuk mund të vërtetohen, në këtë rast BPrAL-t kanë bërë shkelje ligjore dhe se për këtë duhet të japin përgjegjësi para organeve kompetente të drejtësisë. Mirëpo përgjegjësisë nuk mund t'i ik as MASHT-i, pasi përgjegjës për inspektim dhe monitorim e institucioneve të arsimit të lartë është Inspektorati i Arsimit në MASHT.⁴¹ Në bazë të ligjit i cili ka qenë në fuqi deri në vitin 2018, inspektorati i arsimit ka pasur për detyrë inspektimin e rregullt të bartësve të arsimit të lartë.⁴² Në këtë drejtim duhet theksuar se inspektorati i arsimit ka qenë rregullisht i paralajmëruar nga zyrtarët e MASHT-it në lidhje me mos dorëzimin e librave amëz dhe shkeljeve ligjore nga BPrAL, mirëpo inspektorati i arsimit nuk ka vepruar ndaj shkeljeve ligjore të kolegjeve për mos dorëzimin e librave amëz⁴³, ku në një rast inspektorati i arsimit ka marr vendim për vërtetimin e diplomave pavarësisht faktit që kolegji nuk ka dorëzuar kopjet fizike të librave amëz⁴⁴

Një gjendje e tillë a amnistisë ndaj bartësve të arsimit të lartë në Kosovë, si dhe moszbatimi i kontrollit dhe inspektimeve nga MASHT-it, ndaj institucioneve private të arsimit të lartë padyshim se “ushqen” parregullsitë si dhe korrupsionin në arsimin e lartë. Me këtë rast, pasojat

³⁹ Takim me zyrtarët e lartë në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 05/12/2019

⁴⁰ Kodi Penal I Republikës së Kosovës, neni 407 ; Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme merr, fsheh, asgjëson, dëmton apo në ndonjë mënyrë tjetër e bën të papërdorshme vulën, regjistrin, shkresat apo dokumentet zyrtare që i përkasin ose janë në posedim të organit publik apo personit tjetër juridik i cili ushtron autorizime publike, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, <https://md.rks.gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CD1EC.pdf>

⁴¹ Ligji Nr. 06/L -046, Për Inspektoriatin e Arsimit në Republikën e Kosovës, neni 7, <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=17744>

⁴² Ligji Nr. 04/L-037, Ligji për inspeksionin e arsimit në Kosovë , neni 4 paragrafi 4.1, <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2453>

⁴³ Takim me zyrtarët e lartë në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 05/12/2019

⁴⁴ Raport mbi gjendjen faktike të librave amëz i dërguar nga zyrtarët e MASHT-it.

direket do t'i bartin mbi supet e tyre më së shumti studentët të cilët në këto raste konsiderohen të pa diplomuar.